

**KONTRATE SHITBLERJE TE KUOTAVE TE KAPITALIT TE SHOQERISE**  
**“Aquila 2022” sh.p.k**

Ne Lezhe sot me date **11 /02/ 2022** ne seline e Shoqerise “Aquila 2022” Shpk, me seli u paraqiten personalisht :

**PALA SHITSE**

**Edmond Fizi**, atësia Ndrec, amësia Marije, shtetas Shqiptar, lindur në Ungrej, Lezhë dhe banues në LEZHË, me adresë Kastriot 03070047; Nd. 20; H. 1; Lezhë; Lezhë; 4501; Lezhë, lindur më 26/04/1986, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 031972413 dhe nr. personal I60426092F , **NR. kontakti** 068 29 24 410, [fiziedmond@gmail.com](mailto:fiziedmond@gmail.com) ne cilesine e ortakut te shoqerise i cili zoteron 70 % te vleres se kapitalit te shoqerise e barabarte me vlerë 70.000 leke, nr. pjeseve 1

**PALA BLERESE**

**Silvestro Riceputi**, atesia Giovanni, i datelindjes 01.01.1961, lindur ne Catanzaro CZ , Itali dhe banuese ne Milano, Corso Roma, 156 Cologno Manzese, MI , pajisur me Karte ID Italiane me nr. CA75293AY/ 297220, nr. tel.+39 3356956473 , Email [fiziedmond@gmail.com](mailto:fiziedmond@gmail.com)  
Palet e mesiperme, madhore e me zotesi te plote per te vepruar, kerkuan nga une noteria redaktimin e miratimin e aktit te shitjes se Kuotave te kapitalit te Shoqerise , bazuar ne nenin 705 e vijues te Kodit Civil, si vijon :

**1 - Kushtet paraprake**

Pala shitese eshte ortak i Shoqerise “Aquila 2022” shpk sebashku me **Znj. Ilda Gjekaj**, me seli ne Lezhe Shengjin SHENGJIN Njesia Administrative Shengjin ne zonen kadastrale numer 3126, Pasuria Numer 3/127-N6, Kompleksi TWIN TOWERS, Kati pare, **N I P T I – M27506506N**, shoqeri e rregjistruar prane QKB me date **06.01.2022** , me kapital te rregjistruar **100.000** (njqindmije) Leke .  
Ortaket e shoqerise ka shprehur vullnetin e tij ne Vendimin e Asamblese se Ortakeve **nr. 02 i datës 11.02.2022** , qe 40% te kuotave qe ai zoteron ne Shoqerine “Aquila 2022 ” shpk, t’ia shese blesit Silvestro Riceputi.

**2- OBJEKTI**

-Qellimi I kesaj kontrate eshte transferimi I pronesise te kontributeve ne para qe kane shitesit ne kapitalin e shoqerise te blesit me vleren e percaktuar ne nenin 3 .  
-Kjo kontrate sherben per percaktimin e kriterëve, kontributeve, procedurave dhe menyres se transferimit te pronesise dhe pageses perkatese lidhur me kete transferim .  
-Ne percaktim te kushteve , palet konsiderojne te ligjshme permbajtjen e saj dhe marrin persiper te ekzekutojne veprimet e tyre brenda kushteve te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi .  
Nepërmjet kesaj kontratë pala shitëse , i shet palës blerëse 40 % te pjeses takuese te kuotave qe ka ne Shoqerine “Aquila 2022” Shpk .

**3- ÇMIMI**

Palet kane rene dakort qe çmimi I shitjes se 40% te kuotave nga pala shitese tek pala blerese do te jete ne vleren prej 40 000 leke ( dyzetmije ).

Palët deklarojnë se çmimi I kesaj kontrate nga pala blerese tek pala shitese eshte likujduar jashte kesaj zyre noteriale në formën Cash dhe asnjera nga palet nuk ka pretendime te tjera lidhur me kete fakt.

**NENI 4 - Të drejta dhe detyrime të palëve**

**4.1. Të drejta dhe detyrime të shitësit**

- 4.1.1. a. Shitësi garanton blerësin për mungesën e ndonjë shkaku ligjor ose jo që mund të sjellë si pasojë zhveshjen e blerësit nga pronësia mbi kuotat objekt kontrate.
- b. Shitësi merr përsipër t’i shese kuotat e kapitalit objekt kontrate blerësit, të lira nga çdo pretendim apo e drejtë e të tretëve.

- 4.1.2. a. Shitësi është përgjegjës për çdo të metë të kuotave të kapitalit objekt kontrate që ekzistonte në çastin e kalimit të pronësisë edhe kur të metat shfaqen pas këtij momenti.
- b. Shitësi është përgjegjës edhe për çdo të metë që i ka ardhur pronësive mbi kuotat objekt kontrate për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të tij.
- c. Përgjegjësia e shitësit në këto raste konsiston në eliminimin e të metave dhe shpërblimin e dëmit që i është shkaktuar blerësit ose në zgjidhjen e menjëhershme të kontratës dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.
- 4.1.3. Shitësi shkarkohet nga përgjegjësia për të metat e e pronësive se kuotave objekt kontrate kur provon se këto kanë ardhur pas kalimit të pronësisë tek blerësi ose si shkak i veprimeve me faj të blerësit.
- 4.1.4. Shitësi mund të kërkojë zgjidhjen e menjëhershme të kontratës kur:
- Blerësi nuk paguan çmimin ose edhe një pjesë të tij,
  - Blerësi me faj kryen veprime që çenojnë pronësinë e shitësit jashtë lejlimeve të kësaj kontrate.

#### **4.2. Të drejta dhe detyrime të blerësit**

- 4.2.1. Blerësi duhet ta verë në dijeni shitësin brënda dhjetë ditëve, nga marrja dijeni për çdo pretendim apo të drejtë të të tretëve mbi pasurinë objekt kontrate duke specifikuar natyrën e pretendimit.
- 4.2.2. Blerësi pranon ti bleje kuotat e kapitalit dhe deklaron se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këte fakt .
- 4.2.3 Kur për kuotat objekt kontrate, pas shitjes konstatohen të meta që ekzistojnë para se të kalonte pronësia tek blerësi, ky i fundit përveç shpërblimit të dëmit mund të kërkojë nga shitësit edhe:
- a- Eliminimin e të metave.                      b - Uljen e çmimit                      c - Zgjidhjen e kontratës.
- Blerësi mund të kërkojë kthimin e të gjithë çmimit ose të një pjese të tij ku ka arsye të druhet se pronësia mbi kuotat e kapitalit apo pjesë të tyre mund të pretendohen nga të tretët.

#### **4.3. Të drejta dhe detyrime të përbashkëta të palëve**

- 4.3.1. a. Të metat e një pjese të kuotave objekt kontrate janë shkak për zgjidhjen e kontratës me të njëjtin efekt sikur këto të meta të shtriheshin mbi të gjithë kuotat e kapitalit objekt kontrate.
- b. Si të meta të kuotave objekt kontrate, në kuptimin e kësaj kontrate kuptohen barrët dhe kufizimet mbi të drejtën e pronësisë se tyre dhe çdo fakt tjetër i ngjashëm me këto.

### **5- KALIMI I PRONËSISË**

Pronësia mbi 40% të kuotave të kapitalit të rregjistruara të Shoqërisë “ Aquila 2022” sh.p.k që ka ortakun Edmond Fizi /shitësi , do të kalojnë tek pala blerëse **Silvestro Riceputi** , pas depozitimit të kësaj kontrate në QKB Lezhe.

Nga momenti i depozitimit të kontratës në QKB Lezhe, pala shitëse humbet drejtën e pronësive mbi 40% takuese të kuotave që ka në Shoqërinë “Aquila 2022 “ sh.p.k dhe këto të drejta fitohen nga pala blerëse duke u bërë kështu Silvestro Riceputi bashkëortak i shoqërisë, zotëruar me 40 % të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “Aquila 2022” Shpk me vlerë kapitali në para 40.000 leke, sëbashku me bashkëortaket e tjera Edmond Fizi me 30 % pjesëmarrje në kapital ( me vlerë kapitali 30.000 leke ) , Ortaku Ilda Gjekaj me 30 % pjesëmarrje në kapital ( me vlerë kapitali 30.000 leke )

### **6 - Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni, zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

-Kjo kontrate është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe konkretisht të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 83, 705 e vijues të tij. Çështjet që kjo kontrate nuk i rregullon shprehimisht do të rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

-Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate midis palëve, do të zgjidhet me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjelltë midis palëve në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Kur midis palëve nuk arrihet zgjidhja e mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhe.

### **7 -DISPOZITA TE VECANTA**

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë

-Ekstrakti i QKB i shoqërisë.

-Vendimi i Asamblese së ortakeve të Shoqërisë me nr 02 date 11 02 2022

-Dokumentat e identifikimit të palëve kontraktuese

Detyrimet dhe të drejtat që burojnë nga kjo kontratë fillojnë efektet e tyre ligjore nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate.  
Përpunimi i të dhënave në akt do të bëhet në respektim të plotë dhe zbatim rigoroz të dispozitave të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 – i ndryshuar “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Kontrata iu lexohet palëve me zë të lartë, të cilët e kuptojnë, e pranojnë përmbajtjen e aktit dhe e nënshkruajnë atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin, nënshkrimin .  
Kontrata redaktohet në katër kopje origjinale, me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike  
Një kopje do të depozitohet nga blerësi pranë QKB Lezhe.

**PALA SHITESE**

**Edmond Fizi**

*Edmond Fizi*



**PALA BLERESE**

**Silvestro Riceputi**

*RICEPUTI SILVESTRO*

*[Handwritten signature]*

**Perkthyesi Zyrtar**

